

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Nesrin Lushta, kryetare e kolegjit, Agim Maliqi dhe Emine Mustafa, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarit V.H., për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitje e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.2 i KPRK-së dhe veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.2 të KPRK-së, duke vendosur, sipas kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë e paraqitur nga mbrojtësi i të dënuarit, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti për Krime të Rënda PAKR.nr.44/2017 të datës 29.11.2017 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.59/2018 të datës 27.03.2018, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datë 15.05.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit V.H. e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti për Krime të rënda PAKR.nr.44/2017 të datës 29.11.2017 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.59/2018 të datës 27.03.2018.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prizren, me aktgjykimin, PAKR.nr.44/2017 të datës 29.11.2017, të dënuarin V.H., e ka shpallur fajtor, për veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitje e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.2 i KPRK-së dhe i ka caktuar dënim burgimi në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite e 6 (gjashtë) muaj dhe dënim me

gjobë në shumë prej 1.000 (njëmijë) €, kurse për veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitje e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.2 i KPRK-së, i ka caktuar dënim burgimi në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite, ashtu që i ka shqiptuar dënim unik burgimi me kohëzgjatje prej 4 (katër) vite në të cilin është llogaritur koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak prej datës 01.09.2016 deri me datën 16.05.2017. Po ashtu ka shqiptuar dënimin plotësues ashtu që nga i dënuari janë konfiskuar: sasi e përgjithshme e substancave narkotike në peshë prej 672,69 gr., 1 (një) revole të markës TT të kalibrit 7.62 mm, 32 fishek të kalibrit 7.62 mm, 32 fishek 9 mm, mbishkrim PPU dhe 800 kapsolla ndezëse për eksploziv të vendosura në 8 kuti nga 100 copa, 44 kartëmonedha me apoena 500 euro, një kartëmonedhë prej 200 euro, dy kartëmonedha me apoena prej 200 euro, dy kartëmonedha në apoen prej 50 euro, katër kartëmonedha prej 10 euro, si dhe 18 kartëmonedha me apoena prej 5 euro, një portofol me disa kartela bankare, një telefon i markës iPhone me numër serik 359278066446310, një telefon i markës Samsung me numër të imeit dhe një automjet i markës J., ngjyrë .. targa ...-KS-.... I akuzuari obligohet të paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së gjykatës, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 300 €, në afat prej 15 dite pasi aktgjykimi të merr formën e prerë.

Vendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës

Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PAKR.nr.59/2018 të datës 27.03.2018, ka aprovuar ankesën e mbrojtësit të dënuarit V.H., av. H.K., duke ndryshuar aktgjykimin e kundërshtuar vetëm përkitazi me vendimin për dënimin, ashtu që për veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitje e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.2 i KPRK-së, i caktoi dënim burgimi në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite, kurse dënimin me gjobë në shumë prej 1.000 (njëmijë) € e merr si të vërtetuar, kurse për veprën penale mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.2 të KPK-së, dënimin me burgimi në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite, e merr si të vërtetuar, ashtu që konformë nenit 80 të KPRK-së, i ka shqiptuar dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) vite, në të cilin dënim i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak nga data 01.09.2016 deri me 16.05.2017. Ankesa e Prokurorisë Themelore në Prizren, është refuzuar si e pabazuar, kurse pjesa tjetër e aktgjyimit ka mbetur i paprekur.

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë, ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit, avokati H.K. nga Prizreni, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, ta aprovoj si të bazuar kërkesën dhe të i anuloj, aktgjykimet e kundërshtuara dhe çështjen ta kthej në gjykatën e shkallës së parë në rivendosje.

Mendimi i Prokurorit të Shtetit

Prokurori i Shtetit i Kosovës në Prishtinë, me parashtrësën KMLP.II.nr.92 /2018, të datës 02.05.2018, ka propozuar, që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit, të refuzohet si e pabazuar.

Pretendimet e paraqitura në kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë

Në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, theksohet se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së shkallës së dytë, janë marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1, nënëpar.1.12 të KPPK-së, në të dy aktgjykime nuk janë paraqitur faktet dhe rrethana që përbëjnë elementet e veprave penale. Gjykata e shkallës së dytë me rastin e vendosjes për ankesë vetëm ka përshkruar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe nuk ka paraqitur faktet vendimtare në të cilat mbështetet aktgjykimi në fjalë përkitazi me ekzistimin e veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitje e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.2 i KPRK-së. Pretendohet se në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë, nuk janë arsyetuar faktet vendimtare përkitazi me veprimet e të dënuarit për këtë veprë penale dhe nuk vërtetohet se kujt ia shiti i dënuari lëndën narkotike, me cilin person ka pasur marrëveshje për shitje si dhe çmimi i blerjes së lëndës narkotike si element përbërës i kësaj veprë penale, meqë në shkresat e lëndës nuk përmendet asnjë person që i dënuari të ketë pasur marrëveshje apo të ekzistonte ndonjë marrëveshje për çmimin dhe dorëzimin e lëndës narkotike.

Më tutje pretendohet se edhe përkitazi me veprën penale mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.2 të KPK-së, i dënuari është shpallë fajtor

vetëm bazuar në ekspertizën e ekspertit B.H., nga e cila ekspertizë gjykata e shkallës së parë nxjerr konkludim të gabuar përkitazi me faktin se 800 kapsollat e gjetura në shtëpinë e të dënuarit janë të gatshme për përdorim. Kapsollat nuk kanë poseduar azot dhe gjykata në mungesë të këtij materiali shtesë (azotit) nuk ka bërë sqarim për faktin se a mund të përdoren dhe a janë të rrezikshme për përdorim kapsollët duke marrë parasysh faktin se janë gjetur në dhomën e të dënuarit.

Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është i paqartë, i pakuptueshëm dhe në kundërshtim me arsyet e paraqitura dhe në kundërshtim të plotë me provat e administruara e sidomos përkitazi me konfiskimin e dobisë pasurore dhe nuk është marrë parasysh se paratë e konfiskuara janë marrë kredi në Bank nga i dënuari dhe bashkëhuamarrëse ka qenë bashkëshortja e tij K.H., kurse pjesa tjetër e parave ka qenë huazim që i dënuari e ka marrë nga motra dhe dhëndri i tij Sh. dhe Xh.P.

Në kërkesë më tutje, theksohet se nuk është vërtetuar fakti se sendet e konfiskuara janë produkt i veprës penale e me këtë rast edhe procedura e konfiskimit nuk është zhvilluar sipas dispozitave ligjore që rregullojnë konfiskimin e me këtë janë shkelur edhe të drejtat e palëve të treta.

Përkitazi me shkeljen e ligjit penal pretendohet se me rastin e konfiskimit të dobisë pasurore është shkelur dispozita e nenit 385 par.1 nënpar.4 të KPPK-së.

Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e mbajtur shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes dhe në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPPK-së dhe pasi vlerësoi pretendimet në kërkesë konstatoi se:

kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk është e bazuar.

Nuk janë të bazuara pretendimet e paraqitura në kërkesë, se aktgjykimi i shkallës së parë dhe aktgjykimi i shkallës së dytë, janë marrë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale. Në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë janë paraqitur fakte të plota dhe të qarta dhe në mënyrë të detajuar janë arsyetuar të gjeturat e gjykatës së shkallës së parë. Aktgjykimet e kundërshtuara nuk përmbajnë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, meqë të

gjitha faktet janë vërtetuar në mënyrë të plotë dhe për secilin fakt janë paraqitur të dhëna të arsyetuara në secilën pikë të aktgjykimit dhe janë dhënë arsye duke vlerësuar faktet e vërtetuara dhe të pavërtetuara. Gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye pasi ka vlerësuar secilën provë të administruar e sidomos faktet kundërthënës përkitazi me veprimet e të dënuarit për veprat penale që i vihen në barrë.

Pretendimi i paraqitur në kërkesë, se i dënuari nuk ka kryer veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitje e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.2 i KPRK-së nuk është i bazuar. Sipas arsyetimit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, nuk qëndrojnë argumentet e mbrojtjes pasi që është vërtetuar se në veprimet e të dënuarit janë përmbushur elementet objektive dhe subjektive të figurës së veprës penale në fjalë siç është përcaktuar me dispozitën e nenit 273 par.2 të KPRK-së, meqë nuk është kontestuese se në shtëpinë e të dënuarit është gjetur sasia e lëndës narkotike e llojit mariuhanë me sasi prej 672,69 gr. e cila paraprakisht ishte transportuar me automjetin e tipit “J...” me tabela të regjistrimit ...-KS-... nga pastiçeria deri në shtëpinë e tij, ashtu që pastaj lënda narkotike zbulohet në shtëpinë e të dënuarit nga zyrtarët policor. Për më tepër lënda narkotike është transportuar me automjetin në fjalë vërtetohet edhe me faktin se në automjetin e tipit “Jaguar” me tabela të regjistrimit ...-KS-..., është zbuluar vendi i destinuar përkatësisht bunkerit për transport e në të cilin bunker është zbuluar edhe një sasi tjetër e lëndës narkotike të llojit mariuhanë përkatësisht i llojit të njëjtë siç ishte gjetur në shtëpinë e të dënuarit. Pretendimi se nuk janë vërtetuar çmimi i blerjes, se nuk është zbuluar marrëveshja dhe personi të cilit do të duhej ti shitej lënda narkotike nuk janë relevante për ekzistimin e kësaj vepre penale. Mjafton fakti i posedimit të lëndës narkotike i cili është i pakontestueshëm dhe qëllimi i shitjes e që në rastin konkret, gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar mjaftueshëm faktin se i dënuari me qëllim të shitjes së lëndës narkotike ka kontaktuar me personit E., e po ashtu edhe ia ka ofruar për shitje lëndën narkotike përmes kontaktit telefonik.

Pretendimi se i dënuari nuk e ka kryer veprën penale mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.2 të KPK-së, po ashtu nuk është i bazuar meqë bazuar në arsyetimin e gjykatës së shkallës së parë është vërtetuar se sasia e armëve siç është përshkruar në dispozitivin e aktgjykimit të shkallës së parë është gjetur me rastin e kontrollit të zyrtarëve policor sipas urdhrin të gjykatës në dhomën e të dënuarit dhe me këtë rast

është bërë konfiskimi i tyre, ashtu që gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar faktin se armët i dënuari i ka poseduar duke mos pasur leje për posedimin e tyre.

Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, është i qartë dhe i kuptueshëm në të gjitha pikat e arsytimit të saj dhe përkitazi me faktet vendimtare ka paraqitur arsyetim të detajuar për çështjet thelbësore përkitazi me pretendimet e paraqitura në ankesë. Posaçërisht gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsyetim përkitazi me marrjen e dobisë pasurore përkatësisht konfiskimin e parave duke mos i besuar dëshmisë së dëshmitares Sh.P., përndryshe motra e të dënuarit përkitazi me dhënien e borxhit në shumë prej 14.500 €, pasi që nuk ka mundur të argumentoj mënyrën e sjelljes së mjeteve monetare në Kosovë dhe për këtë ka pasur shpërputhje mes të dënuarit i cili fillimisht ka deklaruar se ka huazuar shumën prej 10.000 € e pastaj shumën prej 14.500 €. Kurse sa i përket dëshmitares tjetër K.H., përndryshe bashkëshortja e të dënuarit po ashtu gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar faktin se kredia e marrë nga Bank në shumë prej 10.000 € ishte marrë në muajin prill 2016, por tërheqja e kredisë është bërë pjesë-pjesë. Gjithashtu kontradikta ka pasur edhe përkitazi me destinimin e kredisë. Deri sa i dënuari në mbrojtjen e tij pohon faktin se marrja e kredisë është bërë për renovimin e lokalit, dëshmitarja thekson se kredinë e kanë marrë për ndërtimin e shtëpisë e të cilat kontradikta janë arsyetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e shkallës së dytë, e të cilat konstatime i pranon në tërësi edhe Gjykata Supreme e Kosovës.

Gjykata Supreme e Kosovës, konstatojë se konform dispozitës se nenit 385 par.5 të KPPK, kur është fjala për vendimin për dënim, shkelje e ligjit penal bëhet kur në marrjen e vendimit për dënim, dënimi alternativ, vërejtja gjyqësore ose në marrjen e vendimit për masën e trajtimit të detyrueshëm për rehabilitim apo për konfiskim të dobisë pasurore të fituar me veprën penale, gjykata ka tejkalluar kompetencat ligjore.

Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë nuk ka tejkalluar kompetencat ligjore me rastin kur e ka shqiptuar konfiskimin e dobisë pasurore, meqë vendimi i saj është i bazuar në dispozita të parapara me ligj, kështu që pretendimet e mbrojtësit të të dënuarit të paraqitura në kërkesë se aktgjykimi është përfshirë në shkelje të ligjit penal nuk është i bazuar.

Nga këto arsye, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë ishe e pabazuar dhe konform nenit 437 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.123/2018, më datë 15.05.2018

Bashkëpunëtori profesional,

Bujar Balaj

Kryetarja e kolegjit,

Nesrin Lushta